



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:285696

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05508943

AA.nr.326/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit E.U nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës të paditësit, kundër aktgjytimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2912/2019 të datës 24.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit E.U nga Prishtina, ndërsa aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2912/2019 i datës 24.04.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2912/2019 të datës 24.04.2023, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit E.U nga Prishtina me adresë në rrugën e UÇK-së, hyrja B, kati II, nr.2, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 283784 të datës 16.09.2019 të marrë nga e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesa paditësi, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Me propozim që aprovohet në tersi ankesa e paditësit, të detyrohet e paditura MPMS në Prishtinë që t'ia kompensoj paditësit ndryshimin e pagës së pensionit bazë kundrejt atij kontribut dhënës, shumën e tërësishme prej

2015.00 Euro me kamatë vonesë në lartësi 8% interes vjetor duke filluar nga data e padis dhe deri te pagesa definitive dhe shpenzimet të procedurës në konflikt administrativ. Të detyrohet e paditura që paditësit sipas këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuara, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me vendimin e datës 16.09.2019 e ka refuzuar ankesën e parashtruar nga ankuesi z/znj E.U me numër të ID-së: ..., për njohjen e të drejtës me Kategorizim ngase pala me rastin e apikimit për pension bazë nuk ka aplikuar edhe për pension kontributiv.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 06.12.2019, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se Vendimi i kontestuar nga ana e paditësit është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale. Gjykata e shkallës së parë fillimisht ka vlerësuar aspektin formal të vendimit të atakuar me padi. Në këtë drejtim Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se vendimi i atakuar i marrë nga i padituri është në përputhje të plotë me nenin 47, paragrafin të LPPA-së në të cilin përcaktohet: *“Neni 47-Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar 1. Akti administrativ i shkruar përmban:1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);1.4. pjesën përmblyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrative apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.* Gjykata e shkallës së parë poashtu ka gjetur se

pjesa arsyetuese e vendimit është në përputhje me nenin 48 të LPPA-së i cili përcakton: “Neni 48- Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim.1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsytet pse është e zbatueshme në rastin konkret;1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Sa i përket vendimmarrjes në shkallën e dytë të të paditurës, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se procedura administrative e zhvilluar është kryer në përputhje të plotë me nenin 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton: “Neni 132-Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi epror 1. Në rastin e paraparë nga paragrafi 5 i nenit 131 të këtij Ligji, organi epror do të shqyrtoj ankesën dhe, nëse është e nevojshme, do të zhvillojë shqyrtime shtesë, apo do të urdhërojë organin kompetent që të zhvillojë shqyrtime të tilla dhe të njoftojë për to. Paragrafi 2 dhe 3 I nenit 131 të këtij Ligji zbatohen edhe në këtë rast. 2. Organi epror, me akt administrativ, do të refuzojë ankesën nëse ankesa është e papranueshme, apo është e pabazuar, në pikëpamjen e ligjshmërisë apo përshtatshmërisë. 3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsytet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar. 4. Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala. 5. Nëse është e nevojshme, organi epror mund të urdhërojë organin kompetent që të formulojë aktin që do të nxirret nga organi epror, bazuar në udhëzimet e këtij të fundit. 6. Ankesa nuk do të përkeqësojë situatën juridike në dëm të palës që ka paraqitur ankesë, përpos nëse shprehimisht është paraparë ndryshe me ligj”. Gjykata e shkallës së parë i ka shqyrtuar dhe vlerësuar si të drejta dhe të sakta konstatimet faktike të të paditurës se paditësit i ishte miratuar kërkesa për realizimin e pensionit kontributpagues dhe atë me vendimin e datës 19.07.2017, ndërkaq paditësi para datës 29.06.2017 nuk kishte parashtruar kërkesë për realizimin e së drejtës në pension kontributpagues pasi që deri në këtë kohë nuk kishte prova për vërtetimin e realizimit të kësaj të drejte dhe në momentin që paditësi i kishte plotësuar kushtet ligjore, atëherë i është hapur mundësia për kategorizim sipas përgatitjes shkollore dhe mbi këto argumente e paditura kishte nxjerrë vendimin me të cilin paditësit i ishte njohur e drejta në kategorizim me përgatitje superiore shkollore. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë ka gjetur se e paditura ka vendosur brenda kufijve të kërkesës së paditësit duke i njohur të drejtën në pension kontributpagues, sipas kërkesës së paditësit, por jo jashtë kufijve kohorë të kërkesës së tij. Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se qëndrimi i të paditurës dhe bazueshmëria ligjore është plotësisht e bazuar në legjislacionin përkatës, në prova dhe fakte mirë të provuara. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njëjtat i ka vlerësuar si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në Gjykatë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimet e ankimuara nuk janë të përfshira me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se padia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LPK-së dhe LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pabazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës, dhe aktgjykimi janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Ngase nga provat e administruara rezulton se në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, gjykata pasi ka shqyrtuar provat e administruara dhe dispozitat ligjore në fuqi mbi bazën e të cilit është bazuar vendimi kontestuese me të drejtë ka konstatuar se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se, gjykata e shkallës së parë i ka shqyrtuar dhe vlerësuar si të drejta dhe të sakta konstatimet faktike të paditurës se paditësit i ishte miratuar kërkesa për realizimin e pensionit kontributpagues dhe atë me vendimin e datës 19.07.2017, ndërkaq paditësi para datës 29.06.2017 nuk kishte parashtruar kërkesë për realizimin e së drejtës në pension kontributpagues pasi që deri në këtë kohë nuk kishte prova për vërtetimin e realizimit të kësaj të drejte dhe në momentin që paditësi i kishte plotësuar kushtet ligjore, atëherë i është hapur mundësia për kategorizim sipas përgatitjes shkollore dhe mbi këto argumente e paditura kishte nxjerrë vendimin me të cilin paditësit i ishte njohur e drejta në kategorizim me përgatitje superiore shkollore. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë ka gjetur se e paditura ka vendosur brenda kufijve të kërkesës së paditësit duke i njohur të drejtën në pension kontributpagues, sipas kërkesës së paditësit, por jo jashtë kufijve kohorë të kërkesës së tij

Ndërsa pretendimet ankimore të paditësit se në afat ligjorë kam aplikuar për pension kontributdhënës të moshës, dhe se punëtorët në sportele nuk kanë arritur ta ndihmojnë e pastaj ka shkuar te Drejtori i Mirëqenies Sociale edhe aj i ka thënë se nuk i ke 15 vite përvoje pune. Pastaj se pas një kohe Drejtori i Fabrikës së Amortizatorëve I.B e ka njoftuar vëllain tim se të gjithë punëtorët janë duke e marrë pensionin kontributdhënës, mirëpo vëllai me ka tregu pas 5-6 muajve dhe se ka shkuar te Drejtori i Mirëqenies Sociale dhe i dorëzova dokumentet, ai më tha

se tani mundesh me apliku, Unë propozoj që të merret në pyetje edhe Drejtori i Fabrikës së Amortizatorëve dhe të dëshmoj se a ka qenë pengës nga ana e të paditurës që mos me lënë me i dorëzua dokumentet për pension kontributdhënës të moshës. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuara, sepse nuk ka ofruar prova konkrete ose dëshmi përkatësisht ndonjë emër të specifikuar të punonjësve të të paditurës që do të thirrej nga gjykata për të dëshmuar. Andaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshme, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Prandaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.326/2023 me datë 06.03.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi